

Drejtoria Rajonale Burrel
Njësia e Prokurimit

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____._____.2025

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR –
PUNË”**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Rikonstruksion i rrjetit TM-10KV, TU 0.4kV me kabëll ‘A.B.C’ në Njësinë Kurbin, Drejtoria Rajonale Burrel, Zona: Bushnesh, Dukagjin”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

31321100-3 Linja ajore të energjisë elektrike

VLERA E FONDIT LIMIT:

104,175,828 (njëqind e katër milion e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e njëzet e tetë) **lekë pa TVSH, me të ardhurat e “OSSH”, Sh.A.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria Rajonale e OSSH, Burrel** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1, dhe Listën e Çmimeve (sipas zërave të preventivit) sipas Shtojcës 2;

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, dhe 2024** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën **1 (një)** nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 100 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023, dhe 2024**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

- 2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2025** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar), në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.** Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore **mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.** Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.**”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. **Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.**

Nëse kërkohen bilance të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.”

Ndërsa në **nenin 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**”

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, dhe 2024 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më pak se 100 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet, dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2022, 2023, 2024) të konfirmuar nga administrata tatimore, pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 (i ndryshuar), vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim, ndërsa bilancet duhet të paraqiten nga secili anëtar.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të aktivitetit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 (i ndryshuar), shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **200%** e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Në rast se punimet janë kryer **me ente publike**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit dhe situacionet progresive/pjesore
- iii. Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
- v. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim
- vi. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

b) Në rast se punimet janë kryer **në sektorin privat**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit
- iii. Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore
- iv. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim
- v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast, respektivisht duhet të paraqesë: Kontratën e

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

Bashkimit të Operatorëve dhe Prokurën e Posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve që ka marrë përsiper të kryeje secili anëtar i BOE.

- *Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e nënkontraktimit, kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin Zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.*

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/c dhe 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar), në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale**. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në **nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 5 dhe 8** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Ndërsa në **nenin 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

*“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.***

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kriteret janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kriteret detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

Njësia përcaktoj kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qënë se këto kriteret janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Referuar natyrës së kontratës për punë publike, njësia vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentacionit ligjor të zbatimit të punimeve, bazuar në ligjin Nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe akteve në zbatim të tij, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b të VKM-së, të paraqesin dhe kontratat e sipërmarrjes, situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudimit (*si dhe certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve*), për të vërtetuar faktin, nëse operatori ekonomik pjesëmarrës zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës në masën e përcaktuar sipas nenit 39 pika 5 të VKM-së, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të paraqitet dhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre, pasi në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, si dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë. Gjithashtu, për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin dhe kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin Zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor, kërkesë kjo në përputhje të përcaktimeve të ligjit për prokurimin publik, pasi në rast të kundërt nuk do të identifikohesh nënkontraktimi është kryer me miratimin e autoritetit kontraktor, dhe nëse ka qënë i tillë për kryerjen e punimeve.

Duke qënë se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që A.K., të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar.

Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**
 - **Kategoria NP-1 (Punime gërmimi në tokë) – Klasifikimi A**

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

- **Kategoria NP-11** (Ndërtim për N/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e mesëm dhe shpërndarjen e energjisë) – **Klasifikimi D**
- **Kategoria NP-12** (Punime të inxhinierisë së mjedisit) – **Klasifikimi A**
- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:**
 - **Kategoria NS-1** (Punime për prishjen e ndërtimeve) – **Klasifikimi A**
 - **Kategoria NS-8** (Ndërtim parafabrikat me beton arme, struktura metalike dhe druri) – **Klasifikimi A**
 - **Kategoria NS-18** (Punime topogjeodezike) – **Klasifikimi A**

* Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- Çertifikatë **ISO 9001:2015** (Për sistemin e menaxhimit të cilësisë) e përditësuar
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** (Për sistemin e menaxhimit të mjedisit) e përditësuar
- Çertifikatë **ISO 45001:2018** (Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare, e përditësuar
- Çertifikatë **ISO 27001:2013** (Për menaxhimin e sigurisë së informacionit) ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare, e përditësuar
- Çertifikatë **ISO 50001: 2011** (Për sistemin e menaxhimit të energjisë) ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare, e përditësuar
- Çertifikatë **PAS 99: 2012** (Për sistemin e menaxhimit të integruar) ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare, e përditësuar
- Çertifikatë **ISO 39001:2012** (Për menaxhimin e sigurisë në trafikun rrugor) ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare, e përditësuar

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave dhe objekti i tyre të përputhet me objektin e prokurimit. Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencën – Kodi III.2.B - “*Për grumbullim, transportim dhe depozitimi i dherave dhe mbetjeve inerte*”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme.

2.3.5 **Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:**

- Shtylla b/a të centrifiguara
- Përcjellës ALÇ – 25 mm²
- Traversa model “Y” për linja 10 kV
- Izolator Porcelani 10 Kv
- Ndarës Linje të Jashtëm
- Siguresa TM
- Kabllot e Tensionit të Ulët (A.B.C)
- Aksesoret e linjave ABC
- Kabëll Koaksial Cu 1 x 6/6 mm
- Kabëll Koaksial Cu 4 x 10 mm
- Tokëzim shtylle TU
- Panel “TU” 0.4 KV
- Kabëll PVC TU 06/1 kV

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

1. **Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar**, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave lëshuar/ lidhur jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi/ Marrëveshja bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, dhe të jetë i vlefshëm vetëm për këtë objekt deri në realizimin e plotë të punimeve. (Në rastet kur autorizimi është në gjuhë të huaj duhet të bëhet përkthimi në gjuhën shqipe dhe noterizimi i tij). Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit (të përkthyer në shqip dhe të noterizuara).

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

2. Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket (katalogjet duhet të paraqiten në gjuhën shqipe ose angleze).

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **dëshmi të testimeve zyrtare të kryera**, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi të kryera më parë, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mësipërme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara. (Test raportet për listen e mësipërme të artikujve duhet të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen)

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a, 2 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar), në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;... c) aftësinë teknike dhe profesionale;...

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 dhe 8 të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) **licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose**

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës;

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. ”

Në **nenin 40 pika 6/ b dhe c** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

Gjithashtu në **nenin 44 “Kërkesat e cilësisë”** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: **“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.**

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

1. Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar), neni 8 i tij në të cilin përcaktohet se, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore, dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” në të cilin ndër të tjerash përcaktohet se, subjekte private a publike që kryejnë investime në ndërtime me fonde private ose prokurojnë me fonde publike kanë detyrimin për kontraktim vetëm subjekte të licensuar, sipas kësaj rregulloreje, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë liçensën profesionale për zbatimin e punimeve, me **kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlojit të objektit të punimeve, ku sipas preventivit të punimeve OE duhet të disponojnë: kategorinë NP-1 (Punime gjërmimi në tokë)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv për punimet e gjërmimit (Gjërmim kanalesh në tokë të fortë, Gjërmim dheu me eskavator goma..., Gjërmim dheu për gropa shtyllash..., etj); **kategorinë NP-11 (Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)** e cila përfshin të gjitha zërat e punimeve në preventiv për punimet e rikonstruksionit të linjave të shpërndarjes së energjisë elektrike, të rrjetit TU; **kategorinë NP-12 (Punime të inxhinierisë së mjedisit)** duke qënë se punimet objekt prokurimi do të kryhen në mjedis të jashtëm, ku përfshihen zona me bimësi të llojeve të ndryshme; **kategorinë NS-1 (Punime për prishjen e ndërtimeve)** në lidhje me zërat e punimeve të prishjes në preventiv (Demontim shtyllë betoni, Demontim traversa..., Ulja dhe mbledhja e telit... etj.); **kategorinë NS-8 (Ndërtime parafabrikat me beton arme, struktura metalike dhe druri)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv (Struktura monolite betoni..., shtresë rëre etj.), si dhe **kategorinë NS-18 (Punime topogjeodezike)** - duke qënë se në projekt e preventiv janë parashikuar punime të natyrës topogjeodezike siç është pikëtimi i shtyllave etj., është e nevojshme zotërimi dhe i kësaj pike liçense, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë propocionale me objektin e kontratës.

2. Njësia e prokurimit gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar çertifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime, ku më hollësisht:

- ISO 9001:2015, është kërkuar me qëllim vërtetimin e efektivitetit dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së operatorit ekonomik, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove, duke bërë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.
- ISO 14001:2015, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana tij (në rastin

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis, si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra, ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

- ISO 45001:2018, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgaditjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor, ku veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.
- ISO 27001:2013, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik në lidhje me garantimin e ruajtjes së informacioneve financiare e personale ndaj humbjes, vjedhjes, dhe dëmtimit nëpërmjet një kuadri sistematik, si dhe përputhshmëria me kërkesat ligjore statutores, rregullatore dhe kontraktuale, ku kjo i jep siguri autoritetit kontraktor për ofertuesit, se këto të fundit kanë marrë masat e nevojshme në mbrojtjen e të dhënave të tyre dhe parandalimin e situatave kërcënuese me qëllim sigurimin e vazhdimin të aktivitetit të tyre.
- ISO 50001: 2011, është kërkuar me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik pjesëmarrës ndjek një qasje sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, në lidhje me zbatimin e kësaj qasje në pajisjet, sistemet, proceset dhe personelin që kontribuojnë në performancën e energjisë, gjë e cila i jep garancinë autoritetit kontraktor se veprimtaria e ofertuesit është në përputhje (konform) me politikën e performancës të shpallur të energjisë.
- PAS 99, është kërkuar me qëllim vërtetimin se, operatorët ekonomik pjesëmarrës në veprimtarinë që ushtron (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) përmbush të gjitha përgjegjësitë e tij ndaj klientëve, furnizuesve dhe investitorëve, në rastin konkret ndaj A.K., duke përforcuar besimin në mirëorganizimin e tij si sipërmarrës për përfundimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Ky çertifikimi konfirmon faktin që ofertuesi ka një qasje të saktë ndaj zhvillimit dhe zbatimit të sistemit të saj të menaxhimit të integruar.
- ISO 39001, është kërkuar me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e qarkullimit rrugor, si dhe të reduktojë apo përjashtojë rreziqet e humbjes së jetës dhe plagosjeve të rënda në aksidentet e qarkullimit rrugor. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit ku

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

kemi kryerjen e punimeve në rrugë automobilistike nacionale dhe urbane ku mundësia për ngarkesën e trafikut rrugor është e lartë si nga automjetet ashtu dhe nga këmbësorët, me qëllim minimizimin e këtij risku, është e domosdoshme që ofertuesit të jenë të pajisur me këtë certifikim.

3. Referuar preventivit të punimeve, duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve dhe, *shkulje shtyllash etj.*, dhe kryerjen e transportit të tyre në venddepozitimet e miratuara, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” **ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të liçencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto liçenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.**
4. Gjithashtu, njësia e prokurimit bazuar në preventivin e punimeve objekt kontrate, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ku disa prej tyre duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t’i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dëshmitë e testimeve zyrtare të kryera për këto materialeve, **me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga A.K., nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit.**

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

- 2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se 55 (*pesëdhjetë e pesë*) **punonjës** për periudhën 3 (*tre*) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në licencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libreze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Elektrik**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Hidroteknik**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Mekanik**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Mjedis**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Gjeolog**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

b) Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë minimumi **34 (tridhjetë e katër) punonjës** të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- Teknik ndërtimi – jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Elektriçist – jo më pak se **25 (njëzet e pesë)** punonjës, ku jo më pak se **5 (pesë)** prej tyre të jenë të pajisur me kategorinë e IV-të ose V-të të Sigurimit Teknik.
- Murator/ Karpentier – jo më pak se **4 (katër)** punonjës
- Saldator – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Montator – jo më pak se **2 (dy)** punonjës

* Për përmbushjen e kësaj pikë operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë punonjësit sipas specialitetit të kërkuar, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontrata e punës e vlefshme, Kartelat përkatëse të Sigurimit Teknik, ndërsa për teknikun duhet të paraqitet diploma e shkollës së mesme, si dhe të gjithë punonjësit e kërkuar të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6.

c) Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë **1 (një) mjek** të përgjithshëm, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin: Kontratë të vlefshme pune/ kontratë shërbimi mjeku, Urdhër mjeku, dhe Diplomë.

d) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, dëshmi/ çertifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, diplomat (vetëm për punonjësit inxhinierë të kërkuar), si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, punonjës të kualifikuar/ çertifikuar si më poshtë:

- Minimuni **1 (një) inxhinier** të disponojë çertifikatë/dëshmi si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.
- Minimuni **1 (një) inxhinier** që përmbush kriteret për të qenë **“Përgjegjës për dëmet në mjedis”**.
- Minimuni **1 (një) punonjës** specialist si **Ekspert zjarrëfikës** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, të çertifikuar nga Drejtoria e MZSH-së.

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

- Minimuni **1 (një) punonjës** që përmbush kriteret për të qenë ***“Përgjegjës për Sigurinë dhe Kontrollin e Cilësisë”***.

Disponimi i stafit mbështetës do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

- e) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij, të paktën **4 (katër)** punonjës të specializuar dhe certifikuar për punime në lartësi, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, ku për përmbushjen e kësaj pikë operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë punonjësit në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontrata e punës e vlefshme, dhe certifikatat/ dëshmitë e trajnimit përkatëse lëshuar nga një organizëm i licencuar/certifikuar.
- f) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, *ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Librezë pune (përkatëse)
 - CV përkatëse
 - Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
 - Diplomë

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, këto kërkesa, plotësohen nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar, minimumi **4 (katër) manovratorë** (eskavatoriste/automakinist), të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6 në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruar janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, dhe në çdo rast, *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për secilin të paraqiten:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,
- Dëshmi Kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar).

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

Në **nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 6/b** dhe **c** dhe **8** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: **“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:**

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Ndërsa në **nenin 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriteret janë të detyrueshme për t'u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kriteret detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

1. Kriteri i vendosur për disponimin e një punësimi mesatar jo më pak se **55 (pesëdhjetë e pesë) punonjës**, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së, dhe nenit 39 pika 6/c të VKM-së, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, autoriteti kontraktor ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit sipas kushteve të parashikuara në Shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve teknike” dhe afatit të kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentat e tenderit, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

elektronike” si dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar), njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve, dokumenta të cilat nuk përbëjnë kosto shtesë për plotësimin e dokumentacionit nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Ndërsa në lidhje me periudhën e kërkuar, për të paktën 3 muajt e fundit, njësia e prokurimit në hartimin e këtij kriteri iu është referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, **ku ka vlerësuar të nevojshme që për vërtetimin e bindjes se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një qëndrueshmëri dhe besueshmëri në fuqinë punëtore që realisht disponon**, ka kërkuar që ky punësim të disponohet deri në 3 (tre) muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit, kërkesë e cila është e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuese.

2. Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit objekt prokurimi sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe **vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën**, njësia e prokurimit referuar zërave (natyrës) të punimeve që do të kryhen objekt kontrate, **vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara**. Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë preventivitet të punimeve *(nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik)*, ku më hollësisht parashatrojmë:
 - Është kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, me qëllim menaxhimin e zbatimit të punimeve ndërtimore, analizimin e projektit pasi kemi të bëjmë me punime ndërtimi të gërmimeve, vendosjes së shtyllave, shtresave të betonit, shtresave me rërë, çakull etj., ku është e nevojshme suporti teknik i inxhinierit të ndërtimit dhe ndjekjen e ecurisë së punimeve në kantier;
 - Është kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier Elektrik, pasi ky objekt ka për qëllim rikonstruksionin e linjave të shpërndarjes së energjisë elektrike, ku është e nevojshme që punimet të zbatohen dhe kontrollohen në mënyrë konkrete nga ana e inxhinierit;
 - Është kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier Hidroteknik, pasi referuar vendodhjes së punimeve objekt prokurimi, ku shumë prej tyre do të kryhen në qendra të banuara, dhe gjatë gërmime mund të kemi dëmtime të linjave të furnizimit me ujë, KUZ dhe KUB, lind e nevojshme që punimet të ndiqen dhe nga inxhinieri hidroteknik me qëllim minimizimin e dëmtimeve të këtyre linjave/ tubacioneve, si dhe riparimin e tyre në rast dëmtimi në përputhje me kushteve teknike të zbatimit;

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

- Është kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier Mekanik, pasi shtrirja e linjave të shpërndarjes së energjisë elektrike, varur në shtylla ka nevojë për mbikqyrje nga ana e inxhinierit mekanik, duke qenë që linjat kanë shtrirje dhe peshë të konsiderueshme. Gjithashtu inxhinieri mekanik do të mbikqyrë edhe ecurinë e mjeteve të gërmimit, të transportit etj., të cilat do të përdoren për punimet e këtij objekti;
- Është kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier Mjedisi, pasi duke qenë se punimet do të kryhen dhe në mjedis të pasur me bimësi, pyje etj., ku do të hapet traseja e linjave, dhe do të kryhen gërmime në thellësi të tokës, lind e domosdoshme disponimi i këtij inxhinieri me qëllim shmangien e dëmtimit të panevojshëm të mjedisit dhe burimeve në të, pasi mbrojtja e mjedisit gjatë kryerjes së punimeve ka një rëndësi shumë të lartë;
- Është kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier Gjeolog, pasi referuar projekt-preventivit të këtij investimi kemi punime gërmimi për vendosjen e shtyllave në terrene e sipërfaqe të ndryshme të tokës, ku inxhinieri gjeolog është i nevojshëm për përcaktimin kategorisë së dherave dhe formacionin tokësor në të cilat mund të kryhen këto punime me qëllim mbajtjen e peshës së shtyllave, linjave të shpërndarjes dhe mosdëmtimin e tyre;
- Është kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder, pasi do të kryejë azhurnimin topografik dhe piketimin e linjës së shpërndarjes së energjisë elektrike dhe në bazë të këtij azhurnimi do të llogariten edhe punimet e tjera sipas terrenit si dhe do të ndjekë punimet e zbatimit sipas kuotave të projektit. Gjithashtu pas përfundimit të punimeve do të bëjë edhe azhurnimin faktit (as built);

ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 42, datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*.

3. Po ashtu, referuar natyrës, dhe përmasave/ volumit të punimeve që përmban objekti i prokurimit, **me qëllim vërtetimin e aftësisë zbatuese të kontratës**, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomik duhet të disponojnë stafin mbështetës të kualifikuar për kryerjen e të gjitha punimeve objekt prokurimi, të cilët duhet të jenë me specialitetin: *Teknik ndërtimi, Elektriçist, Murator/ Karpentier, Saldator dhe Montator*, pasi pa këto punonjës nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt kontrate prokurimi, ku ndër të tjerash, është kërkuar që të paraqesin certifikatat e sigurimit teknik *lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar)*, ndërsa për teknikun duhet të paraqitet edhe diploma (dëftesat) përkatëse, me qëllim vërtetimin se këto punonjës janë të kualifikuar për kryerjen e punimeve objekt kontrate, dhe kanë njohuri për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë në lidhje kryerjen e punimeve, përdorimin

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

e mjeteve, marrjen e masave mbrojtëse etj., **në zbatim të Rregullores së Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike**, si dhe të figurojnë të punësuar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6.

4. Në lidhje me marrjen e masave për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, në zbatim të nenit 23 të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”* në të cilin përcaktohet se, citojmë: *“1. Çdo punëdhënës i një subjekti publik apo privat, vendas apo i huaj, është i detyruar të mbulojë me shërbim mjekësor, nëpërmjet mjekut të punës, të përshtatshëm për rreziqet që paraqet vendi i punës.”*, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.108, datë 09.02.2011 *“Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”* (i ndryshuar me VKM-në nr.632, datë 15.07.2015), në të cilin ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: *“7.Personi përgjegjës, i ngarkuar nga shërbimi i specializuar jashtë ndërmarrjes për menaxhimin e riskut, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:... b) në lidhje me shëndetin në punë të ketë formim profesional në fushën e mjekësisë së përgjithshme dhe i cili: b.1 të jetë kualifikuar si mjek i sëmundjeve profesionale/mjek pune; b.2 të jetë i licencuar nga Urdhri i Mjekut për ushtrimin e profesionit;...”* **duke qënë se është detyrim ligjor mbulimi me shërbim mjekësor të ndërmarrjes nga ana e punëdhënësit, dhe mbulimi i këtij shërbimi në aspektin shëndetësor duhet të kryhet nga mjeku i punës i licencuar, njësia e prokurimit vlerëson se, kërkesa për disponimin e mjekut të ndërmarrjes ose të kontraktuar është një detyrim ligjor për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar në përputhje me ligjin, duhet vërtetojnë disponimin e tij.**
5. Referuar natyrës së punimeve që do të kryhen, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të disponojnë në stafin e tyre personelin e kualifikuar/ certifikuar:
 - Në lidhje me kërkesën për disponimin si pjesë të stafit të punësuar 1 (një) inxhinier që disponon certifikatë/dëshmi si ***“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”***, njësia e prokurimit vlerëson se, kjo kërkesë është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi ky inxhinier i certifikuar **nevojitet për përshtatjen e kantierit sipas fazave të punimeve, mbajtjen e kantierit në kushte të rregullta, kontrollin e materialeve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë dhe/ ose shëndetin e punëmarrësve, si dhe verifikimin e zbatimit të planit të sigurisë dhe koordinimit gjatë zbatimit të punimeve** kërkesa kjo në zbatim të nenit 9 dhe 10 të ligjit të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”*, dhe nenit 2, 5 dhe 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 *“Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”*.

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

- Kërkesa për disponimin e 1 (një) inxhinierit që përmbush kriteret për të qenë **“Përgjegjës për dëmet në mjedis”**, shërben për kontrollin dhe marrjen e masave në kohë me qëllim parandalimin apo minimizimin e efekteve negative që i vijnë mjedisit gjatë kryerjes së punimeve objekt kontrate, kërkesë kjo në zbatim të ligjit 10 431, datë 09.06.2011 **“Për mbrojtjen e Mjedisit”** (i ndryshuar) dhe akteve në zbatim të tij, duke garantuar në këtë mënyrë vazhdimin e kryerjes së punimeve objekt kontrate dhe shmangien e pezullimit të tyre si pasojë e dëmtimit të mjedisit dhe masave të marra nga inspektoriatet e mbrojtjes së mjedisit.
 - Në lidhje me kërkesën për disponimin e 1 (një) Ekspert zjarrefikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, të pajisur me certifikatën përkatëse lëshuar nga MZSH, njësia e prokurimit vlerëson se, kjo kërkesë është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi stafi operacional i operatorit ekonomik duhet të jetë i trajnuar për çdo rast emergjence, ku ndër to janë edhe rastet e zjarrit, kërkesë kjo bazuar në parashikimet e nenit 38 të Ligjit Nr. 152/2015 **“Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”**, **në të cilin përcaktohet se, personat fizikë dhe juridikë zbatojnë dispozitat e parashikuara nga ky ligj dhe akte të tjera nënligjore, në lidhje me marrjen e masave për parandalimin e pakësimit e zjarreve, me anë të mjeteve, sistemeve, pajisjeve të diktimit-sinjalizimit për shuarjen e zjarreve, gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre.**
 - Në lidhje me kërkesën për disponimin e 1 (një) punonjës të certifikuar si **“Përgjegjës për sigurinë dhe kontrollin e cilësisë”**, vlerësohet si kërkesë e nevojshme, pasi duhet që një punonjës të jetë i specializuar në sigurinë dhe kontrollin e cilësisë në lidhje me punimet që do të kryhen dhe mallrat/materialet që do të furnizohen dhe vendosen në objektin e prokurimit, ku, referuar rëndësisë së veçantë që ka investimi objekt prokurimi, **vlerësohet me rëndësi fakti që të disponohet një punonjës me këto njohuri të posaçme mbi kontrollin e cilësisë, pasi duke qënë prezent gjatë gjithë periudhës së punimeve ai vlerëson dhe kontrollon cilësinë e çdo punimi dhe materiali që kryhet dhe vendoset në objekt**, kërkesë kjo e cila i shërben A.K. për vërtetimin se operatori ekonomik jep garanci se punimet objekt prokurimi do të jenë brenda standarteve të kërkuara.
6. Në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatorit ekonomik në stafin e tij, të paktën **4 (katër)** punonjës të specializuar dhe certifikuar për punime në lartësi, **njësia e prokurimit vlerëson se kjo kërkesë është e domosdoshme, duke qënë se bazuar në preventivin e punimeve kemi të bëjmë me kryerje të punimeve në lartësi (mbi 2 m) për vendosjen e linjave të shpërndarjes së energjisë elektrike në shtylla, si dhe kemi punime në terrene me lartësi dhe pjerrësi të theksuar**, kërkesë kjo në zbatim të përcaktimeve të nenit 11 të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 **“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”**, dhe pikës

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

13 të Aneksit V/ Seksioni II/ Pjesa B e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”, ku për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të paraqesë kontratat e punës (të vlefshme), dhe Çertifikatat përkatëse të punonjësve që do të angazhojë për kryerjen e këtyre punimeve.

7. Po ashtu, me qëllim ndërtimin e objekt kontratës sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, duke qënë se vlera e preventivuar për punimet që do të kryhen është mbi 30,000,000 milion, në zbatim të Udhëzimit Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçensimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, kjo dhe në rastin kur ofertuesi merr pjesë si bashkim i operatorëve ekonomik, secili anëtar duhet të përcaktojë/ deklarojë drejtuesin teknik të punimeve, si dhe të paraqesë dokumentacionin e kërkuar.
8. Gjithashtu, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet që të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar për disponimin në stafin e tyre, e të paktën **4 (katër) manovratorë** (eskavatoriste/automakinist), të cilët duhet të disponojnë dëshmitë e nevojshme për drejtimin e mjeteve të rënda të kërkuara, me qëllim kryerjen e punimeve të gërmimeve, pasi pa këto mjete nuk mund të kryhen punimet objekt kontrate. Në përcaktimin e numërit të punonjësve manovratorë, është përcaktuar duke patur parasysh volumin e punimeve që do të kryhen, si dhe sasinë dhe llojin e mjeteve që nevojiten për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

Punonjësit, specialistët, inxhinierët dhe stafi i kualifikuar të kërkuar i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 në DST, duhet që nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t’u paraqitur, të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.9 (Makineri, Pajisje)

Drejtoria Rajonale Burrel Njësia e Prokurimit

- a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet, makineritë dhe pajisjet (**sipas tabelës**) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Përshkrimi i Automjetit/ Makinerisë/ Pajisjes	Sasia
1.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	jo më pak se 2 copë
2.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5 – 10 ton	jo më pak se 2 copë
3.	Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	jo më pak se 2 copë
4.	Autovinc transportues mbi 5 ton	jo më pak se 2 copë
5.	Eskavator me goma MT	jo më pak se 1 copë
6.	Eskavator me zinxhire	jo më pak se 1 copë
7.	Fadromë me goma MT	jo më pak se 2 copë
8.	Minieskavator/ Minifadromë	jo më pak se 2 copë
9.	Rimorkiator për transport mjeteesh	jo më pak se 1 copë
10.	Tokmak ngjeshës	jo më pak se 1 copë
11.	Vibrator betoni	jo më pak se 2 copë
12.	Betoniere	jo më pak se 1 copë
13.	Kit vegla pune	jo më pak se 10 copë
14.	Set karrukulla për shtrirjen dhe tërheqjen e kabllave për pozicione horizontale dhe për këthesa 90 grade	jo më pak se 15 copë
15.	Kambaleca për mbajtjen e barabaneve të kabllave	jo më pak se 2 copë
16.	Kenotron për kablllo	jo më pak se 1 copë
17.	Terraometër për matjen e rezistencës së tokëzimit	jo më pak se 2 copë
18.	Pajisje tërheqëse për përcjellës (deri 30 KN me lexim elektronik)	jo më pak se 1 copë
19.	Megahometër 2500 -5000 volt	jo më pak se 2 copë
20.	Prese kapikordash	jo më pak se 1 copë
21.	Gjenerator për kantierin	jo më pak se 2 copë
22.	Saldatriçe	jo më pak se 2 copë
23.	GPS	jo më pak se 1 copë
24.	Set sinjalistike për punime në rrugë	jo më pak se 1 set

- b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtëse në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

- Kokore + Jelekë fosforeshentë – *jo më pak se 55 copë*
- Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 5 copë*
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 10 copë*
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra – *jo më pak se 5 copë*

□ **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**

- 1- Për mjetet që shënohen në rregjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 2- Për mjetet e siguruar me qira, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 3- Për paisjet në pronësi të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes (*të paktën 1*).
- 4- Për paisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes (*të paktën 1*).
- 5- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe te pranojë verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- 6- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklarohet se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.** 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në **nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 6/d** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “**6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:...** d) **mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.**”

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriteret janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kriteret detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme, njësia e prokurimit vlerëson se **operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë automjetet, mjetet dhe pajisjet e kërkuara me anë të cilave do të kryhet punimet dhe transporti i materialeve sipas zërave të punimeve të përcaktuara në preventivin e specifikimet teknike objekt kontrate**, ku sasia e tyre është kërkuar në përpjestim me natyrën e përmasat e këtyre punimeve, ku një operator ekonomik pa këto mjete e pajisje nuk mund t’i realizojë këto punimeve. Gjithashtu në zbatim të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”,

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”, **njësia e prokurimit ka kërkuar që operatorët ekonomikë duhet të disponojnë dhe pajisjet mbrojtëse për punonjësit të cilët do të angazhohen për kryerjen e punimeve objekt kontrate.** Njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm që duhet të paraqesin operatorët ekonomik pjesëmarrës me qëllim vërtetimin e disponimit të tyre, dhe dokumentacionin tekniko-ligjor për automjetet të cilat duhet të regjistrohen në regjistrat publik për qarkullimin e tyre.

2.3.10 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë autoritetit kontraktor **një mostër për:**

- Shtylla b/a të centrifiguara
- Përcjellës ALÇ – 25 mm²
- Traversa model “Y” për linja 10 kV
- Izolator Porcelani 10 Kv
- Ndarës Linje të Jashtëm
- Kabllot e Tensionit të Ulët (A.B.C)
- Panel “TU” 0.4 KV
- Kabëll PVC TU 06/1 kV

- **Mosdorëzimi i mostrës për secilën pajisje/material të kërkuar ditën e hapjes së ofertave dhe në rast se mostrat nuk janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike e përcaktuara në DST, përbën kusht për s’kualifikim.**

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar**

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në **nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 2** dhe **8** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “**2. Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.**

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Në **nenin 40 pika 6** gërma “a” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose...”**

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, referuar materialeve që do të instalohen në investimin objekt prokurimi, të cilat duhet të jenë sipas standarteve dhe

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

specifikimeve teknike të kërkuara, për shkak të jetëgjatësisë që duhet të kenë si materiale, përtej periudhës së garancisë së punimeve të kërkuar, njësia e prokurimit e vlerëson të rëndësishëm kushtin e paraqitjes së mostrës për këto mallra/pajisje ditën e hapjes së ofertave, **me qëllim që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të ketë mundësinë për të kontrolluar nëse këto materiale/pajisje që do të përdoren në realizimin e punimeve objekt kontrate janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit.**

2.3.11 Afati i kryerjes së punimeve:

Operatori ekonomik duhet të paraqesi grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Argumentimi:

Në nenin **15 pika 3/a** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: “**a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;**”

Njësia e prokurimit referuar të dhënave teknike të projektit, ku parashikohet dhe afati i kryerjes së punimeve bazuar në grafikun e punimeve, vendosi miratimin e afatit të punimeve prej **180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë kalendarike nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit**, vlerësuar si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

❖ Argumentimi në lidhje me pikën 2.16/ Seksionin 2 të Njoftimit të Kontratës në dokumentat e tenderit:

Në zbatim të **nenit 90 pika 6** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Njësia e prokurimit e prokurimit nuk ka lejuar mbështetjen e ofertuesit në kapacitetet e subjekteve të tjera për përmbushjen e kriterëve si më poshtë janë përcaktuar:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

☐

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

Nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera në lidhje me përmbushjen e kërkesave për kualifikim të përcaktuara në pikën 2.3.2, 2.3.6, dhe 2.3.7 gërma “a dhe b”, që ka të bëjë me disponimin e licencës për zbatimin e punimeve, detyrat që duhet të ushtrojë stafi inxhinierik si dhe kryerjen e punimeve nga punonjësit e specializuar sipas kualifikimit të kërkuar.

Referuar sa më lart, Njësia e Prokurimit vlerëson të rëndësishëm faktin e ndalimit të mbështetjes së operatorit ekonomik në kapacitetet e subjekteve të tjera në lidhje me disponimin e kategorive të licencës për zbatimin e punimeve, detyrat që do të ushtrojë stafi inxhinierik, si dhe kryerjen e punimeve nga punonjësit e specializuar sipas kualifikimeve të kërkuar, por të përmbushen nga vetë ofertuesi, kjo për arsytet se, *investimi objekt prokurimi është një investim i rëndësishëm ku referuar natyrës së tij, atij të furnizimit të energjisë elektrike*, lind e nevojshme që ofertuesi të jetë vetë i licensuar për kryerjen e këtyre punimeve, si dhe të angazhojë në mënyrë të plotë të gjithë stafin e kërkuar (inxhinierët dhe punonjësit), pasi në të kundërt nuk mund të garantohet kryerja e këtyre punimeve me cilësi dhe siguri, **ku aftësia profesionale e cila bazohet mbi licencimin e operatorit ekonomik dhe punët që do të kryejnë inxhinierët dhe punonjësit e kualifikuar janë të rëndësishme për vërtetimin se operatori ekonomik është i aftë për realizimin e kontratës objekt prokurimi.**

Gjithashtu, arsyeja tjetër është se, edhe pse pjesëmarrja në procedurat e prokurimit me mbështetje të kapaciteteve në subjekte të tjera, **është një risi e ligjit të ri, pa ndonjë paragjykim, po përdoret në shumë raste nga operatorët ekonomikë vetëm për plotësimin e kërkesave për kualifikim, duke mos i angazhuar de facto stafin teknik dhe punonjësit e marrë me mbështetje në kryerjen e punimeve, duke riskuar në këtë mënyrë realizimin e kontratës.** Moslejimi i mbështetjes në kapacitetet mbështetëse asnjëherë nuk pasjell diskriminimin e operatorëve ekonomik të interesuar, pasi, edhe nëse operatori ekonomik pjesëmarrës/ i interesuar nuk arrin të përmbushë vetë të gjitha kërkesat për kualifikim, ai ka mundësinë e përmbushjes së tyre nëpërmjet bashkimit me operatorë të tjerë ekonomik, **kjo gjithmonë nëse ka dëshirën për të fituar kontratën publike dhe më e rëndësishme vullnetin për të kryer punimet me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.**

Shënim:

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s'kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Drejtoria Rajonale Burrel

Njësia e Prokurimit

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen. Përfshirje në vetëm Katalogu për materialet e kërkuar, i cili mund të jetë dhe në gjuhën Angleze.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në specifikimet teknike standarte dërguar nga Dega Teknike/ Drejtoria Rajonale e OSSH, Burrel, për punimet objekt prokurimi, duke qënë se specifikimet teknike të dërguara, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “*Për Prokurimin publik¹*” (i ndryshuar), dhe nenin 39 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për punimet objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.
- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **data 27.10.2025, ora 10.⁰⁰**, vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT